REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 980/20
Datë/Datum. 20.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SUHAREKË**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **624-20-4571-5-1-1, nr. i brendshëm: 624-020-079-511**

Sa i përket tenderit: **Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë Bytyqi -Faza e dytë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

CONSTRUMAX SH.P.K & NNSH„TOP PROJECT''
(Emri i Operatorit Ekonomik)

Rr. Mentor Krasniqi p.n. Bukosh Suharekë, Rr. Ahmet Gashi BL.C-1 Hy.5 Nr.5 - Prishtinë
(Adresa)

Suharekë, Prishtinë — ***23000, 20000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049137004
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Bege Krasniqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@construmax.eu
(Adresa elektronike)

19.11.2020
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. ConstruMax 1 Suhareke

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë dt.18.09.2020 Hapja e ofertave dt.28.09.2020 Njoftimi mbi vendimin e AK-së dt. 02.11.2020 Njoftim Aprovim- Refuzim dt. 11.11.2020 Rivlersim njoftim për Vendim dt. 13.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [ ] **Jo** [X]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së- Qëllimi
Neni 6 i LPP-së- Ekonomiciteti dhe efikasiteti
Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 i LPP-së – Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 67 i LPP-së – Provat shkresore
Neni 68 i LPP-së – Gjendja Ekonomike dhe Financiare
Neni 69 i LPP-së – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 108/A i LPP-së – Zgjidhja preliminare e mosmarrveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar autoriteti kontraktues në njoftimin mbi vendimin e AK-së të dt.11.11.2020 ka hudhur poshtë të gjitha pretendime tona të cekura në Kërkesën për Rishqyrtim, dhe ka kthyer në rivlersim vetëm për pretendimin nr.10 që kemi potencu që OE fitues nuk ju është korrigjuar paramasa dhe ka gabime aritmetike dhe pas kthimit të lëndes në rivlersim ka lëshuar vendimin pas rivlersimit dt 13.11.2020 që ka korrigjuar disa gabime aritemtike të OE dhe ka shtuar disa pika eliminues, duke na ka shpallur si tenderues i eliminuar, ndërsa ka vazhduar me OE fitues të njejtë si në Vendimin e I-rë. Andaj ne si kompani me që në Vendimin e I-re janë hudhur poshtë pretendimet tona kemi vendosur të deponojm ankesë në OSHP-në.

Kompania jonë me të parë njfotimin për kontrat nga AK Komuna e Suharekës kemi vërejt që ka kritere diskriminues, dhe kritere që përcaktojn fituesin, ku me datë 03.09.2020 kemi bërë Kërkes për informacione shtesë lidhur me kriteret diskriminues, dhe na është kthyer sqarimet që janë të nevojshme për këtë kontrat, pastaj me datë 14.09.2020 përësëri kemi dërguar email që të largohen kriteret diskriminues dhe me datë 15.09.2020 kemi bërë Kërkes për Rishqyrtim për largimin e kritereve diskriminues përkatësisht për kriterein **Kërkesa 8- Inxhinjer ose master i diplomuar i Ndërtimtarisë drejtimi infrastruktur rrugore, se paku me 5 vite përvoj pune pas diplomimit** – kriter i cili kemi potencu që plotsohet vetëm nga një person në Kosovë z. Defrim Kabashi që ka diplomuar para 5 vite (sepse dega e infrastruktures është hapur në vitin 2012 dhe personi i parë që ka diplomuar ka qenë z. Defrim Kabashi) dhe kemi kërkuar edhe nëse nuk largohet së paku përvoja e tijë të kërkohet për 3 vite, ku AK më në fund e ka këkruar më 3 vite. Kriter i cili ska pas të bëjë më objektin në fjalë, mirpo inxhinieri i Infrastruktures është i nevojshëm për rrugë magjistrale, autudhë etj. Tani ajo qka kemi potencu është vërtetu nga vetë AK pasi që OE i shpallur fitues e ka kontrat marrveshje me këtë inxhinier, i cili ka kontrata marrveshje edhe me disa kompani tjera në Suharekë që kanë marrë tendera me një OE të përgjegjshëm të cilët kanë pasur marrveshje me këtë inxhinier.

Prov 1: Kërkesa për infromacione shtësë e datës 03.09.2020
Prov 2: Kërkesa për largim të kritereve dsikriminues dt14.09.2020
Prov 3: Kërkesa për Rishqyrtim dt15.09.2020

Andaj bazuar në këto prova dhe kontraten për marrveshje me këtë inxhinier AK vetëm e ka pasur të përcaktuar fituesin për këtë tender pasi që ka shpall fitues OE i cili ka marrveshje me këtë inxhinier.

Gjatë kohës së vlersimi të tenderëve AK për të gjetur arsye për të na eliminuar pasi që e vetmja kompania e përgjegjshme me qmimë më të lirë kemi qenë kompania jonë, ka kontaktuar bashkpuntorët tonë privat dhe institucionet pa na njoftu neve, për të bërë gjetje në kundërshtim me LPP-në, ku ne kemi reguar me emali me datë 25.10.2020 „Reagim- ndaj veprimeve në kundërshtim me LPP-në nga Autoriteti Kontraktues'', pasi bashpuntorët dhe stafi që kemi pasur marrveshje janë ndier të friksuar dhe nën presion nga Zyra e Prokurimit të Suharekës me qëllim të tërheqjes apo gjetjeve të mundshme vetëm e vetëm për na eliminuar

Prov 4: email Reagim- ndaj veprimeve në kundërshtim me LPP-në nga Autoriteti Kontraktues 25.10.2020

Pastaj Autortieti Kontrkatues në pamundësi të gjetjeve për eliminimin e kompanis tonë që kemi qenë kompani ma e lirë se kompania e planfikiuar për shpallje fituese para se mu hap tenderit, ka ngarkuar në e-prokurim me datë 26.10.2020 „Letren standarte e kërkesës për sqarim të tenderit'' duke kërkuar disa sqarime lidhur me inxhiniera, dhe kontratat kopje të disa projekteve që kemi pasur në list të projektit edhe pse kanë qenë të dorzuara referencat

dhe procesverbalet e pranimit teknik, duke na cekur me një afat mjaftë të shkurtër prej 2 ditë për 12 pika për kthimin e sqarimeve. Në diten e 2 e kanë tërhequr AK nga sistemi i e-prokurimit këtë letër standarte pa ndonjë sqarim dhe jemi kontaktu në telefon nga Zyra e Prokurimit që nëse doni muni me lyp kohë shtesë, ku zupozojm që është tentuar të na qesin në lajthitje për të kaluar afatin e përcaktuar prej 2 ditëve. Andaj ne me datë 28.10.2020 kemi dërguar të gjitha sqarimet e kërkuar me dshëmi

Prov 5: letra standarte e kërkesës për sqarim nga AK dt 26.10.2020
Prov 6: Njoftim nga e-prokurimi që është ngarkuar në e-prokurim Kerkesa per sqarime nga AK me datë 26.10.2020
Prov 7: Njoftim nga e-prokurimi që është larguarr në e-prokurim Kerkesa per sqarime nga AK me datë 28.10.2020
Prov 8: Sqarimet e ngarkuara lidhur me kërkesën e AK -sw datw 28.10.2020

Pas sqarimeve të dërguar nga ana e jonë AK pa dhënë ndonjë arsyetim se cilat dëshmi kan munguar apo cilat të dhëna nuk përputhen, me datë 02.11.2020 ka ngarkuar Njoftimin për Vendim duke shpllur OE fitues më të shtrejt se ne OE, i cili ka qenë i planifikuar që do të fitoj këtë tender para Njoftimit për Kontrat, që kriteret kan qenë të vendosura vetëm për këtë OE dhe për inxhinierin e infrastruktures z. Defrim Kabashi i cili ka 5 vite pas diplomimi, dhe neve na kan eliminuar për arsyet që janë kërkuar sqarime për to, të cilat kemi ngarkuar sqarimet e kërkuar me dëshmi.

Prov 9: Kontrata në mes z. Defrim Kabashi dhe OE Euroing
Prov 10: Vendimi i datës ku shpallet fitues OE Euroing dt. 02.11.2020

*Ne menjëher kemi kërkuar qasje në dokumentacion të OE fitues dhe OE tjerë, ku nga qasja kemi vërjet që OE fitues jo vetëm që është i papërgjegjshëm mirpo ka edhe ndërhyrje në paramas në 4 pozicione dhe gabime aritmetike nga këto pozicione që tejkalon **21%** e vlerës rreth **530 mij euro**, si dhe OE tjerë të papërgjegjshëm përpos kompanis tonë*
Ne kemi bërë kërkes për Rishqyrtim me datë 06.11.2020 ku nga AK të gjitha pretendimet tona janë hudhur posht si të pa bazuar vetëm pretendimi nr 10 është shqyrtuar dhe është kthyer në rivlersim për korrigjimin e gabimeve aritmetike vetëm tek elektrika dhe ujsjellsi

Prov 11: Vendimi i datës ku shpallet fitues OE Euroing dt. 02.11.2020

Pas rivlersimit AK përësir ka shpall OE të njejt fitues edhe pse ne kemi cekur të gjitha pretendimet edhe për ndërhyrjet në paramas

Bazuar në faktet e lartëcekura nga inicimi i procedures e deri në këtë fazë, supozojm që AK jo vetëm që nuk ka respektuar LPP-në mirpo AK ka dëshmi të mjaftueshmë për inicimine e lëndës në Prokuri, pasi që ka hapsir të mjaftueshëm që AK ka përgaditur kritere për kompanin e shpallur fituese, dyshojm që ka ndërhy në paramas me planifikim, ka mbrojtë kriteret, dhe nuk ka dashur as të mendoj të respektoj LPP-në duke shpallë fitues Operatorin Ekonomi i cili jo vetëm që është i papërgjegshëm po i cili ka manipuluar me sasi duke ndryshu sasit nga ato të publikuar në paramas dhe duke vendos qmime me % për të vendosur në lajthitje në të ardhmen AK, apo ndoshta edhe AK ka qenë e përfshir dhe kordinuar që në të ardhmen nga kjo kontrat të përfiton OE edhe 530 mije euro pasi që manipulimet e sasive dhe qmimeve vetëm janë pranuar nga AK, ku dyshojm që edhe paramasat para publikimit janë përpunuar apo përgaditur për manipulimet që supozojm që mund të bëhen në të ardhmen.

Andaj kërkojm edhe nga Paneli i OSHP-së që të shqyrtoj me serizoitet mundësin që Udhëheqësit të Prokurimit në Komunen e Suharekës të ja konfiskoj Licencën e Prokurimit pasi që supozojmë që ka bërë shkelje të mëdha ligjore, duke rrezikuar që lënda të shkoj në Prokuri dhe Kryetari i Komunes të përballet me procese ligjore pasi që është kontrat e vlerë së madhe dhe është përgjegjës për nënshkrimin e saj.

Ne në kërkesën për rishqyritm të datës 06.11.2020 ne nuk jemi pajtuar me eliminimin tonë dhe kemi supozouar që nuk u respektua LPP-ja pasi jemi eliminuar me të padrejt, meqë kemi ofruar të gjitha dokumentacionin e kërkuar në dosje të tenderit.

Autoriteti Kontraktues në letrën standard për tenderues të eliminuar (PARËN) ka potencuar "**Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye:**

- I mungon qarkullimi me kontrata 60% liderit te grupit,
- inxhineri i prezantuar i eketroteknikes Z.Nitaj bazuar ne CV e prezentuar eshte ne mardhenie pune ne KEDS dhe i njejti ka kontrate me Operatorin ekonomik me orare te plote prej 8:00-16:00 (40 ore pune ne jave) ku me ligjin e punes 1 zyrtare nuk mund te kete dy madhenie pune ne orare te njejte (të plotë) në të njejten kohë (edhe në KEDS e poashtu edhe te OE).
- Inxhinieri i prezantuar i infrastruktures rrugore z.Qelaj bazuar ne CV e prezantuar eshte i punesuar ne KK Prishtine si Zyrtar per infrastruktur rrugore dhe i njejti ka kontratë me operatorin ekonomik me orarë te plote prej 8:00-16:00 (40 ore pune ne jave) ku me ligjin e zyratreve publik nuk mund te kete dy mardhenie pune me orar te njete (të plotë) në të njejten kohë(edhe në Komuna e Prishtinës edhe në OE).
- Mnibageri i kerkuar nga njesia e kerkeses eshte 1.2 deri 1.7 TON, operatori ekonomik ne marrveshjen e prezantuar ne dosjen e tenderit per pajisjen e ka plotesuar qe eshte 1.2 deri 1.7 TON, mirepo dudi doganor qe i perket kesaj paisje eshte mbi 1.8 TON.

Arsyet shtesë që janë cekur në vendimin e dytë pas kthimit lëndës në rivlersim edhe pse në refuzimin e kërkesë për rishqyrtim është cekur që lënda kthehet në rivlersim vetëm për korrigjim të gabimeve aritmetike, AK ka shtuar edhe disa pika kinse nuk i plotsojm me të vetmin qëllim potencimin e sa ma shumë pikave për të krijuar mjegulli në OSHP-në dhe kinse kan pasur bazë për eliminimit të konzerciumit tonë duke përdor kritere të dyfishta ndaj konzerciumit tonë në krahasim me OE të shpallur fitues dhe kushteve të vendosura vetë në dosje të tenderit

Arsyet eliminues për kompanin tonë në letrën standard për tenderues të eliminuar (DYTEN) pas rivlersimit janë cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsye: -

- I pa kompletuar, i mungon qarkullimi me kontrata 60% liderit te grupit,
- inxhineri i prezantuar i elektroteknikes Z.Nitaj bazuar ne Cv-ne e prezentuar eshte ne marredhenie pune ne KEDS dhe i njejti ka kontrate me Operatorin ekonomik me orar te plote prej 8-16 (40 ore pune ne jave) ku me ligjin e punes 1 zyrtar nuk mund te kete dy marredhenie pune ne orare te njejte.
- Inxhinieri i prezantuar i infrastruktures rrugore z.Qelaj bazuar ne CV-ne e prezantuar eshte i punesuar ne KK Prishtine si Zyrtar per infrastruktur rrugore dhe i njejti ka kontrat me operatorin ekonomik me orare te plote prej 8-16 (40 ore pune ne jave) ku me ligjin e zyratreve publik nuk mund te kete dy marrdhenie pune me orar te njete.

- Minibageri i kerkuar nga njesia e kerkeses eshte 1.2 deri 1.7 TON, operatori ekonomik ne marrveshjen e prezantuar ne dosjen e tenderit per paisjen e ka plotesuar qe eshte 1.2 deri 1.7 TON, mirepo dudi doganor qe i perket kesaj paisje eshte mbi 1.8 TON.
- Pozicioni i pare ne paramase çmimin e ka manipulative, pasi qe ky çmim nuk munt te arsyetohet me asnje rregull e as standard ingjinierik.
- Paramasa te faza e makineris ka nderhyrje nga ana e OE ne formulen e ngarkuar ne system nga ana e AK dhe si pasoj e kesaj jane te paplotesuar pozicionet A24 dhe B20.
- Ingjinieri i Arkitektures Arzije Zeneli ka kontrate te rregullt me OE ndersa sipas listes se ATK-se figuron si punetore JO primare (sekondare) e njejta eshte e punesuar ne MINISTRI.

Ju sqarojmë se arsyeja e Autortieti Kontraktues për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit nuk qëndrojn për arsyet si në vijim:

Pretendimi 1.- - *është që AK na ka eliminuar konzerciumin tonë në kundërshtim me LPP-në dhe pa arsye pasi plotsojm këtë kriter*

Arsyeja e eliminimit kinse na mungon qarkullimi me kontrata 60% liderit te grupit

Kompania jonë si lider i konzerciumit ka dëshmu qarkullim bankar të dorzuar në folderin 3. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Vertetim i qarkullimit nga Procredit bank për NNP Construmax nga data 01.01.2018-01.06.2020 në vlerë prej **1,284,572.88€**
- Vërtetimi i qarkullimi nga Procredit bank për Construmax shpk nga data 01.01.2018 -01.06.2020 në vlerë prej **2,109,230.43€**
- Letër konfirmim nga Teb Banka për NNP Construmax nga 01.01.2017-31.12.2019 në vlerë prej **993,394.99€**
- Letër konfirmim nga Teb Banka për Construmax shpk nga data 21.03.2019 deri 31.12.2019 në vlerë prej **221,948.28€**

Gjithsejt **4,409,392.58€**

Kërkes në dosje të tenderit ka qenë qarkullimi prej 60% i vlerës 5,200,000 që është 3,120,000 €, që dmth ne jo vetëm që e plotsojm 60% po kemi paraqitur dëshmi shumë më shumë se sa ka qenë e kërkuar.

Kompania jonë ka paraqit Listen e kontratave për vitet 2017-2019 që në listë të projekteve janë të evidentuar projekte në vlerë prej **5,162,750.25€**
Mirpo për ti sqaruar që ne jo vetëm që e plotsojm këtë kriter mirpo edhe e tejkalojm po paraqesim listen tabelare të disa projekteve kryesore, duke evidentuar edhe kodet e dokumenteve siq janë të dorzuara me ofertë.

DISA NGA PROJEKTET QË JANË OFRUAR DËSHMI ME REFERENCA APO PROCESVERBALE PËR KOMPLETIM TË PUNIMEVE

a	EMERTIMI	INVESITORI	VLERA E KONTRATËS	Dokumenti deshmues të dorzuara qe jane kryer punimet
1	'Dislokimi I instalimeve ekzistuese dhe përgaditja e lokacionit për ndërtimin e Klinikes se re te Pediatrisë ne QKUK" +Anex kontrata	Ministria e Shëndetësisë	195,232.78	Folderi 4.Referencat; 4.1 referenca CMX1-;1-17 Referenca dislokimi
2	Ndertimi i Impiantit per trajtimin e ujrave te zeza ne Badovc	Project Plus sh.p.k Prishtinë	80,000.00	Folderi 4.Referencat; 4.1 referenca CMX1-;3-17 Referenca imp
3	Renovimi I Konviktit të UPZ +Anex kontrata	Universiteti i Prizrenit „Ukshin Hoti"	397,886.55	Folderi 4.Referencat; 4.1 referenca CMX1-;4-17 Referenca e upz
4	Ndërtimi I objektit për garazha të autoambulntave , akrivës dhe sallës së takimeve" (faza e tretë)	Spitali I Përgjithshëm "Prim. Dr.Daut Mustafa"	37,611.55	Folderi 4.Referencat; 4.1 referenca CMX1-;6-17 referenca garazhat (procesverbal I pranimit teknik)
5	ADAPTIMI I HAPËSIRAVE PER ANGIOGRAF NE QKUK+ Anex kontrata	Ministria e Shëndetësisë	298,745.78	Folderi 4.Referencat; 4.1 referenca CMX1-;2-18 referenca Adaptimi
6	Ndertimi I salles se edukates fizike ne Ratkoc-Rahovec+ Anex Kontrata	Ministria e Administratës Publike	418,153.48	Folderi 4.Referencat; 4.1 referenca CMX1-;3-18 referenca salla ratkoc
7	Ndarja e hapsiarave në Objekte të UPZ	Universiteti i Prizrenit „Ukshin Hoti"	41,988.77	Folderi 4.Referencat; 4.1 referenca CMX1-;7-18 referenca ndarja e hapsirave
8	Renovimi I obejktit të Prokuroisë Themelore në Prizren	PROKURORIA E SHTETIT	38,000.00	Folderi 4.Referencat; 4.1 referenca CMX1; 9-18 procesverbal prokuria
9	Renovimi I sporteleve të Drejtorisë për financa në Komunën e Prizrenit+ Anex kontrata	KK Prizren	48,825.84	Folderi 4.Referencat; 4.1 referenca CMX1; 13-18 procesverbal drejtoria e financave
10	Renovimi I objekiti të zjarrfikësve në Komunën e Prizrenirt	KK Prizren	26,666.00	Folderi 4.Referencat; 4.2 referenca CMX2; 18 Zjarrfiksat Prizren - Procesverbal pranimi teknik
11	Lot 1- Ndërtimi I salles sportive në fshatin Lismir	Komuna e Fushë Kosovës	177,693.00	Folderi 4.Referencat; 4.2 referenca CMX2; Referenc salla lizmir
12	Renovimi ishkolles Heronjet e Lumes ne fshatin Shkoze te Prizrenit	KK Prizren	142,241.42	Folderi 4.Referencat; 4.2 referenca CMX2; Referenc shkolla shkoze
13	Renovimi I Komunës-Përdheses dhe Kulmit per nevojat e projektit #ONESTOPSHOP#-Prizren + Anex Kontrata	Ministria e Administratës Publike	1,017,135.65	Folderi 4.Referencat; 4.2 referenca CMX2; Qertifikata e pranim dorzimit dhe referenca onestopshop
14	Drenazhimi dhe Hidroizolimi i objekteve shkollore ne shml,,12maj'' ne fshatin Ratkoc dhe Shfmu,,Skender Kastrati'' ne Fshatin Malesi e Vogel	Komuna e Rahovecit	56,560.11€	Folderi 4.Referencat; 4.2 referenca CMX2; drenazha rahovec- jane kontrata dhe procesverbali
15	Renovimi i objektit te zjarrfiksave ne Komunen e Prizrenit	Komuna e Prizrenit	26,666.66€	Folderi 4.Referencat; 4.2 referenca CMX2; 19 drenazha rahovec- jane kontrata dhe procesverbali

16	Punimi i dyshmesë në objektin e MASHT-it	MASHT	52,471.65	Folderi 4.Referencat; 4.2 referenca CMX2; kontrata – Punimi i dyshmese ne objketin e MASHT-it dhe punimi i dyshmes - procesverbal
17	„Ndertimi i poligoneve sportive Bukosh, Mohlan, Sopije, Reqan''	NBT-ING	67,200.00€	Folderi 4.Referencat; 4.1 referenca CMX1; 3-17 referenc imp jane dy referencat edhe impian edhe ploigoneve- sqarimet e transaksioneve jane bere ne sqarime te kerkuar nga ju
18	„Ndertimi i poligoneve sportive Bukosh, Mohlan, Sopije, Reqan''	ProjekPlus	80,000.00€	Folderi 4.Referencat; 4.1 referenca CMX1; 3-17 referenc imp jane dy referencat edhe impian edhe ploigoneve- sqarimet e transaksioneve jane bere ne sqarime te kerkuar nga ju
19	Renovation of CT Premises at the Gjilan Hospital	Lux-Development	51,667.48	Folderi 4.Referencat; 4.2 referenca CMX2; 18 spitali gjilan
20	Ndertimi dhe Renovimi i objekteve shendetsore: LOT 3- Renovimi i Objektit te Vjeter Kirurgjis ne Gjakove+ Anex kontrata	Ministria e Shendetsis	407,365.00€	Folderi 4.Referencat; 4.2 referenca CMX2; 19-20 Raporti i pranimit, ku edhe kemi bere sqarimet pas kerkese se juaj
			3,662,111.42€	

Bazuar në kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional ku ka qenë e kërkuar që lideri ta plotsoj 60% e vlerës prej 3,900,000.00€ që është 2,340,000 € kompania jonë jo vetëm që e plotson 60% mirpo edhe e tejkalon komplet vlerën e kërkuar mbi **3,662,111.42€ kemi dëshmu referenca dhe pranime teknike**, po ashtu mund të ofrojm edhe referenca tjera dhe procesverbale në rast që kërkohen si dëshmi shtesë që janë mbi 1 miljon tjera, që janë projekte të evidentuar në Listen e Projekteve.

Andaj ne si kompani konstatojm që eliminimin i jonë për arsyen që i mungon qarkullimi me kontrata 60%, supozojm që jo vetëm që nuk qëndron , mirpo është edhe një fyerje dhe keqpërdorim i detyres së caktuar për vlersimin dhe krahasimin e tenderëve pasi që dëshmit janë të dorzuara të gjitha me ofert dhe kemi evidentuar edhe kodet e dëshmive të dorzuar me ofertë.
Duhet ju rikujojm që Autoritet Kontrkatues ka kërkuar edhe sqarime për të dëshmuar me kontrata disa nga referencat apo procesverbalet që kanë munguar vlerat e kontratve, që kemi bërë sqarimet me dëshmit e kërkuar dhe në arsyen eliminuese nuk është cekur cila dëshmi ju ka munguar

Prov 8: sqarimi lidhur me kerkesen e AK me datë 28.10.2020 në e-prokurim.

Pretendimi 2. ***është që AK ka eliminuar konzerciumin tonë në kundërshtim me LPP-në dhe pa arsye pasi plotsojm këtë kriter***

Arsyetimi i dytë eliminues për kompanin tonë:

- inxhineri i prezantuar i eketroteknikes Z.Nitaj bazuar ne CV e prezentuar eshte ne mardhenie pune ne KEDS dhe i njejti ka kontrate me Operatorin ekonomik me orare te plote prej 8:00-16:00 (40 ore pune ne jave) ku me ligjin e punes 1 zyrtare nuk mund te kete dy madhenie pune ne orare te njejte (të plotë) në të njejten kohë (edhe në KEDS e poashtu edhe te OE).

Në dosje të tenderit nuk ka qenë e specifikuar se si duhet të jenë kontratat apo marrveshjet me inxhinier dhe nuk ka ndalu që mund të jenë të punsuar apo kan qenë të punsuar diku tjetër citojm: *„Kërkesa 5 - Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes, minimum 5 vite pervoj pune pas diplomimit. Dëshmia 3, 4, 5, 6, 7, 8 - Kontratat e punës ose mareveshjet*

me inxhinieret, Diplomat e NOTERIZUAR dhe CV, Diplomat te cilat nuk janë te Republikes se Kosoves duhet te jenë të nostrifikuara nga MASHT - Prishtine dëshmi mbi përvojen e punës – referenca përkatëse për punë të ngjashme''

Kompania jonë së bashku me ofert ka dorzuar listen e stafit shtesë që mund të angazhohen në këtë projekt përpos atyre që kemi vendosur dëshmit e kërkuar në dosje të tenderit

Kompania jonë ka dorzuar dokumetacionin e kompletuar sipas kërkesës në Dosje të tenderit për inxhinierin e elektroteknikes në dokumetat e dorzuar *„5.Staf Profesiona; 5.2 Staf 1 CMX; Inxh. Elketro''* me këto dokumenta:

- CV- e Skender Nitaj që e plotson kërkesën për përvojë pune pas diplomimit 5 vite,
- Diplomen e noterizuar sipas kërkesës në dosje të tenderit,
- Kontraten për bashkpunim nr 16/2020 për këtë projekt
- Referece për dëshmin e përvojes dhe
- Deklaraten e nënshkruar nga vetë ky inxhinier që dëshmon që ka marrveshje për këtë projekt dhe është i gatshum që edhe në rast që është i angazhuar në ndonjë punë tjetër, të ndërpres dhe të vazhdoj në Construmax.

Edhe pse kemi sqarua në letrën sqaruese të kërkuar nga AK të datës 28.10.2020 jemi eliminuar. Kompania jonë ka nënshkru kontrat bashkpunimi për projektin në fjalë me nr.16/2020 me datë 25.09.2020 me z. Skender Nitaj-inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes. Në dokumentacionin e bashkangjitur për inxhinierin e elektronikes janë edhe CV, Referenca, diploma si dhe Deklarat e nënshkruar nga vetë Inxhinieri që deklaron që është i gatshum të udhëheqë punimet si inxhinier i diplomuar i elektroteknikës për këtë projekt dhe në cilën do kohë që është e nevojshme për të kryer detyrat sipas kërkesës së Construmax sh.p.k., **dhe ka deklaru që edhe nëse është i anagzhuar për momentin në ndonjë punë të caktuar është i gatshum të ndërpres punimet menjëher për të shërbyer në kompanin Construmax shpk.** për projektin "Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë Bytyqi - Faza e dytë" me nr. Referent: 624-20-4571-5-1-1. Deklaraten e inxhinierit të elektroteknikes Skender Nitaj i dates 25.09.2020 është e dorzuar me ofert.

Bazuar në ligjin e punës Nr.03/L-312 nuk e ndalon që një i punësuar të mos punoj edhe në pundhënës tjerë, dhe nuk e ndalon të ndërroj pundhënsin, e as nuk e ndalon të merrë pushim pa pages për të shërbyer në një pundhënës tjetër konform neneve përkatës, dhe e drejt e të punsuarit me pëlqimin e tijë është të punoj edhe në këtë project konform kontratës Bashkpunimi për këtë project, dhe i punësuar do të përcjell punimet elektrike konform planit dinamik që do të bëhet me menaxhimin e kontrates dhe do të jetë i gatshum të punoj konform marrveshjes së kontrates dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktues

Andaj ne nuk mund të paragjykojm apo hulumtojn se ku kanë punu apo ku janë duke punuar, ne kemi nënshkru kontrat bashkpunimi me pëlqimin e inxhinierit për këtë project konform ligjit të punës dhe rregulloreve për staf, sqarimeve nga KRPP-ja, vendimeve të OSHP-së, po ashtu kemi dorzu edhe deklaraten e inxhinierit që do të shërbej në këtë project konform kontrates, dhe nuk dëshirojm të paragjykojm për të ardhmen, pasi që zbatimi i kontrates është obligativ si nga i punsuari ashtu dhe nga pundhënësi pasi që ka masa ndëshkues për secilen palë nëse nuk zbatohet. Po ashtu duhet të ju sqarojm që në rast që cili do nga stafi nuk do të përmbahet marrveshjeve kontrkatuale, janë procedura tjera që ndiqen nga kompania jonë dhe kemi stafë rezerv që bashkpunojm dhe mund të bashkpunojm për këtë project. Ne deklarojmë që edhe në rastin më të keqë nëse nuk i përmbahet kontrates i punsuari, ne do të zbatojm të gjitha masat ligjore ndaj tij, dhe do të ofrojm inxhinier të lamis përkatësi me përformanca më të mëdha dhe të pranueshme nga AK, pa e cenuar as edhe një orë udhëheqjen e punimeve nga inxinieri përkatës. Po ashtu gjatë implementimit të projekti Autoriteti Kontraktues konform ligjit për menaxhimin e kontratave mund të inspektoj se a është stafi i anagzhuar dhe të marr masa sipas kontrates.

Gjithashtu ju sqarojm që inxhinierin e elektroteknikes Skender Nitaj është i deklaruar edhe në ATK nga muaji shtator 2020 me datë 14.10.2020 si i punsuar në kompanin tonë, dhe paga ju ka paguar me datë 14.10.2020 për muajin 09/2020 si dhe në rastë që do të shpërblehmi me këtë kontrat do të vlejë edhe Marrveshja e bashkpunimit për projektin nr16/2020. Ky inxhinier përpos që ka qenë bashkpuntor i jashtëm për projekte të caktuara tani edhe është si i punsuar në kompanin tonë nga muaji 09/2020 konform Ligjit të punës.

Prov 12: <u>Lista e pagave që dëshmon që z. Skender Nitaj është i punsuar nga muaji 9/2020</u>

Prov 13: <u>Dëshmi nga banka për pagesen e rrogës për muajin e 9 dhe 10 të 2020</u>

Konsiderojm që arsyeja e eliminimit është në kundërshtim me LPP-në pasi që kemi ofru dëshmi dokumentare që dëshmojn që inxhinieri ka marrveshje për këtë projekt dhe ka dëshmi të mjaftueshme që ky inxhinier do të respektoj marrveshjen e kontrates, si dhe dëshmi listen e pagave që inxhinier që nga muaji 9/2020 është si i punsuar në kompanin tonë.

Pretendimi 3. ***është që AK ka eliminuar konzerciumin tonë në kundërshtim me LPP-në dhe pa arsye pasi plotsojm këtë kriter***

Arsyeja e eliminimit:

- Inxhinieri i prezantuar i infrastruktures rrugore z.Qelaj bazuar ne CV e prezantuar eshte i punesuar ne KK Prishtine si Zyrtar per infrastruktur rrugore dhe i njejti ka kontratë me operatorin ekonomik me orarë te plote prej 8:00-16:00 (40 ore pune ne jave) ku me ligjin e zyratreve publik nuk mund te kete dy mardhenie pune me orar te njete (të plotë) në të njejten kohë(edhe në Komuna e Prishtinës edhe në OE).

Në dosje të tenderit nuk ka qenë e specifikuar se si duhet të jenë kontratat apo marrveshjet me inxhinier dhe nuk ka ndalu që mund të jenë të punsuar apo kan qenë të punsuar diku tjetër citojm: *„Kërkesa 5 - Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikes, minimum 5 vite pervoj pune pas diplomimit. Dëshmia 3, 4, 5, 6, 7, 8 - Kontratat e punës ose mareveshjet me inxhinieret, Diplomat e NOTERIZUAR dhe CV, Diplomat te cilat nuk janë te Republikes se Kosoves duhet te jenë të nostrifikuara nga MASHT - Prishtine dëshmi mbi përvojen e punës – referenca përkatëse për punë të ngjashme''*

Kompania jonë ka dorzuar dokumetacionin e kompletuar për inxhinierin e elektroteknikes në dokumetat e dorzuar *„5.Staf Profesiona; 5.1 Staf 2 CMX; Inxh. Ndertimtaris- Infarstrukture''* me këto dokumenta;

- CV- e Besim Qelaj që e plotson kërkesën për përvojë pune pas diplomimit 5 vite,
- Diplomen e noterizuar sipas kërkesës në dosje të tenderit,
- Kontraten për bashkpunim nr 15/2020 e bashkpunimit për këtë projekt
- Referece për dëshmin e përvojes dhe
- Deklaraten e nënshkruar nga vetë ky inxhinier që dëshmon që ka marrveshje për këtë projekt dhe është i gatshum që edhe në rast që është i angazhuar në ndonjë punë tjetër, të ndërpres dhe të vazhdoj në Construmax.

Kompania jonë ka nënshkru kontrat bashkpunimi për projektin në fjalë me nr.15/2020 me datë 18.09.2020 me z. Besim Qelaj- inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë - Infrastruktures. Në dokumentacionin e bashkangjitur për inxhinierin e Infrastruktures janë edhe CV, Referenca, diploma si dhe Deklarat e nënshkruar nga vetë Inxhinieri që deklaron që është i gatshum të udhëheqë punimet si inxhinier i diplomuar i Ndërtimtaris-Infrastruktures për këtë project dhe në cilën do kohë që është e nevojshme për të kryer detyrat sipas kërkesës së Construmax sh.p.k., **dhe ka deklaru që edhe nëse është i anagzhuar për momentin në ndonjë punë të caktuar është i gatshum të ndërpres punimet menjëher për të shërbyer në kompanin Construmax shpk për projektin** "Ndërtimi i shtëpisë së kulturës Ukë Bytyqi -Faza e dytë" me nr. Referent: 624-20-4571-5-1-1

Deklaraten e inxhinierit të infrastruktures e Besim Qelaj i dates 18.09.2020 është e dorzuar me ofert.

